

ZHVILLIMI I TURIZMIT KULTUROR DUKE ZBULUAR SHTIGJE MALORE DHE DESTINACIONE KULTURORE NË ZONËN NDËRKUFITARE (CULT2ROUTES)

Konteksti

Tanimë, nuk ka asnjë dyshim që turizmi po hyn në kryefjalën e zhvillimit ekonomik, social dhe kombëtar të shumë vendeve, duke përfshirë zonën ndërkufitare Greqi-Shqipëri. Projekti është përqendruar në zonat turistike të zgjedhura të bashkive Nestrami (Greqi) dhe Tepelena (Shqipëri). Megjithëse janë zona me shumë vlera natyrore dhe kulturore, ato ende nuk njihen gjerësisht si destinacione tërheqëse turistike.

Projekti Cult2Routes synon të përmirësojë produktin turistik në zonat atraktive, duke përmirësuar infrastrukturën turistike dhe kulturore në bashkitë e Nestramit dhe Tepelenës, si edhe duke zhvilluar shtigje malore dhe destinacione kulturore me sinjalistika të përshtatshme, panele informacioni dhe hartografi të përshtatshme me mjete elektronike për të tërhequr kështu më tepër turistë.



Objektivat e Projektit

Objektivat specifikë të projektit janë:

- i) Identifikimi i shtigjeve malore në zonën ndërkufitare si dhe përcaktimi i tyre si pjesë e rrjetit Evropian të shtigjeve malore, duke ndjekur standardet për sinjalistikën dhe informacionin e dhënë;
- ii) Promovimi i aktiviteteve rikrijuese në pasuritë kulturore më të rëndësishme në zonën ndërkufitare (NK);
- iii) Përmirësimi i informacionit kulturor e natyror për vizitorët në zonën NK;
- iv) Ndërlidhja e aktiviteteve natyrore si alpinizmi me aktivitete kulturore dhe evente në zonë (si festivali muzikor i Nestramit);
- v) Promovimi i mundësive të reja biznesi;
- vi) Ruajtja, sinjalizimi dhe promovimi i alpinizmit në shtigjet malore.

Produktet

- Identifikimi dhe promovimi i shtigjeve dhe destinacioneve në zonat e projektit;
- Përmirësimi i kapaciteteve të aktorëve turistik për të promovuar më mirë zonat e projektit;
- Restaurime në shkallë të vogël të pasurive kulturore në të dy vendet;
- Promovimi i identitetit kulturor në dy zonat e përzgjedhura;
- Zona të përcaktuara si destinacione të turizmit kulturor;
- Mundësi të reja punësimi dhe sipërmarrje për të rinjtë;
- Rinovimi i qendrës së informacionit për turistët;
- Krijimi i një muri të ri për ngjitje 'climbing wall', trajnim për fillestarët dhe për ngjitesit me përvojë.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Komisioni Evropian

PARTNERËT:

- Bashkia e Nestramit
- Bashkia e Tepelenës
- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)
- Departamenti për Grantet Kërkimore në Universitetin e Maqedonisë Perëndimore

KOHËZGJATJA:

01/11/2019 - 01/07/2022

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.



Interreg - IPA CBC
Greece - Albania
4PLUS